

Një shpërthim ka ndodhur sot afër një xhamie në lindje të Francës, në qytetin Villefranche.

Mendohet se rasti ka lidhje me sulmin e djeshëm në Paris.

Tash për tash nuk ka informata për të lënduar eventuale as për shpërthimin, vetëm që dihet se shpërthimi ka ndodhur afër një xhamie dhe një restoranti, transmeton koha.net.

Policia ka bllokuar qasjen në këtë pjesë dhe po e heton rastin. Spekullohet se ndoshta bëhet fjalë për një lloj hakmarrjeje për sulmin e djeshëm ndaj selisë së gazetës Charlie Ebdo në Paris, ku u vranë 12 persona.

“Unë mendoj se kjo ka lidhje me ngjarjen e tmerrshme të djeshme në Paris”, ka thënë prefekti i Villefranche Peru Bernard.